

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shkatërrohet banda shqiptare e drogës në Belgjikë, arrestohet “Gjenerali” i akuzuar si vrasësi i Naim Zybërit
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/kronike/shkaterrohet-banda-shqiptare-e-s-ne-belgjike-arrestohet-g-i1185095
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:10:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8057c61c825a26d1121061ae742808a399c98aea357c1ec54499da13a7bfe9ba
TEKSTI	9e29eb7f3dcbfb1278c0f9c766863040d6099226fddcfa75712ba6604daef2ba
PAMJA	373d47f1cb09a9d05c94545402e26a68c4cf4abcf192ed9b8cd0264edcab25d2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5be4010a7982d99a59b8fc93592d7a51de78b6bca98fc6ae8be9e260ba291fa3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5f8ef0f8d1c556c1a23c45b5f0b4a2927fefdb161a9dff8be1ca6faf0b0d4224
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5be4010a7982d99a59b8fc93592d7a51de78b6bca98fc6ae8be9e260ba291fa3>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Shkatërrohet banda shqiptare e drogës në Belgjikë, arrestohet “Gjenerali” i akuzuar si vrasësi i Naim Zyberit

Nga A2 CNN
15 Shtator 2026, 14:05 | Kronikë



Një grup i dyshuar kriminal me anëtarë shqiptarë është goditur nga Policia Federale Gjyqësore në Belgjikë, në kuadër të një hetimi për trafikimin e kokainës. Tetë persona janë ndaluar, ndërsa katër prej tyre janë arrestuar me vendim gjykatë.

Lajmi është publikuar nga media holandeze De Telegraaf, e cila raporton se hetimi nisi rreth një vit më parë, pasi autoritetet morën informacion se në një apartament në Berchem, në Antwerp, mund të magazinoheshin sasi të mëdha kokaine, përcjell A2 CNN.

Në qendër të hetimit ishte një 48-vjeçar, i dyshuar si ndërmjetës mes grupeve kriminale në Shqipëri dhe Amerikën Latine. Sipas autoriteteve belge, ai dyshohet se koordinonte transportin, nxjerrjen nga porti dhe shpërndarjen e drogës, përfshirë edhe përmes portit të Antwerp-it. Ai dyshohet gjithashtu se kishte kontakte me grupe kontrabande në vende të ndryshme të Evropës dhe deri në Australi.

Zëdhënësi i Prokurorisë së Antwerp-it, Kristof Aerts, tha se 48-vjeçari dyshohet se ofronte mënyra të ndryshme për trafikimin e drogës, kishte mundësi të siguronte ndihmën e personave, përfshirë roje sigurie, dhe drejtonte grupet që nxirrin drogën nga ngarkesat.

Gjatë hetimit, autoritetet identifikuan disa grupe që merreshin me nxjerrjen e kokainës nga porti. Më herët gjatë këtij viti, policia kishte sekuestruar dy ngarkesa me 46 dhe 53 kilogramë kokainë.

Në kërkim për vrasjen e bujshme të Naim Zyberit

Hetimi mori një tjetër zhvillim në qershor, kur autoritetet zbuluan se i dyshuari kryesor kishte kontakte me një shtetas shqiptar 52-vjeçar, i kërkuar ndërkombëtarisht për një vrasje të kryer në Itali në vitin 1997.

Bëhet fjalë për Gerd Gjinarari, i njohur me nofkën “Gjenerali”, i cili u arrestua në Antwerp nga ekipi FAST i Policisë Federale belge. Sipas De Telegraaf, ai dyshohet se në vitin 1997 qëlloi për vdekje Naim Zyberin, në një spital në Milano, duke përdorur një armë që ishte fshehur mes një buqete me lule, në bashkëpunim me Arben Grorin. Autoritetet belge kanë nisur procedurat për ekstradimin e tij drejt Italisë.

Armë, municione dhe pajisje për falsifikim

Të mërkurën, policia zhvilloi kontrolle në disa zona të Antwerp-it dhe Brukselit, përfshirë Berchem, Deurne, Kapellen, Evere, Sint-Agatha-Berchem dhe Sint-Joost-ten-Node.

TE FUNDIT

“SPAK duhet të shkrihet!” Deputeti i PD bën deklaratën e fortë: Nuk ka ndalur asnjë aferë

Vendimi për ish-krerët e UÇK, Rutte: KFOR do të jetë në Veri pavarësisht verdiktit

Më shumë fitim në vend, Vlorë po “josh” profesionistët të braktisin emigrimin

Mbrojtja zbulon faturën, 42 mijë euro në gjashtë muaj për çdo ushtarak në Gaza

MË TË VIZITUARAT

Prag Liga e Kombeve, Seferi dhe Asani nuk ndalen, protagonistë me ekipet e t...

“E vetmja që fiton është Kina”, Trump: Një konspiracion i sëmurë kundër IA...

Dy yjet më të shtrenjtë, Yamal dhe Haaland marrin skenën e futbollit botëror...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Gjatë kontrolleve u sekuestruan armë zjarri dhe municione të fshehura në hapësira të posaçme, jelekë antiplumb, pajisje bllokuese sinjali, para cash, makineri për numërimin e parave, pasaporta dhe karta identiteti të falsifikuara, si dhe karta shtypi. Policia gjeti gjithashtu presa dhe kallëpe që dyshohet se përdoren për formimin e blloqeve të kokainës.

Tetë persona u ndaluan gjatë operacionit. Gjashtë prej tyre u paraqitën para gjyqtarit hetues. Katër u arrestuan, një u la i lirë me kushte, ndërsa një tjetër u la i lirë.

Hetimi, i drejtuar nga Policia Federale Gjyqësore e Antwerp-it nën drejtimin e gjyqtarit hetues, vijon.

Operacioni është zhvilluar në bashkëpunim me autoritetet e disa vendeve dhe me Europol. Në kuadër të hetimit, në Shqipëri u sekuestruan edhe 37 kilogramë kokainë, të fshehura në një kontejner frigoriferik. **(A2 Televizion)**

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Gjykata e Lartë la në burg Veliajn, Ndreca: Po mbahet peng ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë



Ilir Meta mbetet në burg, rrëzohet kërkesa për lirim nga qelia



Arrestohet në Belgjikë 58-vjeçari nga Shijaku, anëtar i një organizate kriminale



Operacioni i AMP-së, arrestohet efektiv i Policisë në Durrës, procedohen dy të tjerë





Gjykata e Lartë lë në burg Erion Veliajn



Shpërthim me lëndë plasëse në oborrin e një banese në Shijak

Latest Videos



PS kontrollon SPAK! Balliu: SPAK strukturë politike, bën arrestime me sondazhe



"E ka të vetin Ministrin e Brendshëm", Balliu: Klodian Braho mik i afërt me Ervin Demon



Të shkrihet SPAK! Deputeti demokrat bën deklaratën e fortë: Nuk kanë ndaluar asnjë aferë



Gjykata e Lartë e la në burg! Balliu flet për Veliajn: Kështu i intereson Ramës

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulo
Imagjinatë
Dëshmi



A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediaset

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.